



KESH
ENERGJIA E SHQIPËRISE

Nr.4.578/1..... Prot

Tiranë, më 19.08. 2024

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

FTESË PËR NEGOCIATA

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë
Tel/Fax+355 04 225 8977
E-mail mail@kesh.al
Adresa e Internetit www.kesh.al

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:
Emri Juli Binjaku
Adresa Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë
Tel/Fax +355697070248
E-mail juli.binjaku@kesh.al

Autoriteti Kontraktor KESH sh.a do të zhvillojë procedurën botitimi/publikimit me objekt: **“Realizimin e një publikimi të brand-it dhe motos së shoqërisë në një revistë periodike kombëtare me karakter ekonomik”**. Ky publikim duhet të publikohet në një në revistë kombëtare, e cila ka në fokus editorial çështje ekonomike, tragtare dhe biznesi dhe me kohe zgjatje të publikimit për një periudhë prej 1 (një) ditë, në gjuhën shqip, 2 faqe të revistës dhe me ngjyra.

Nevoja për kryerjen e botimit: Në referencë të Memo Nr.4570 Prot. Datë 18.09.2024 është kërkuar realizimi i botimit sipas objektit.

Shpeshësia: Publikimi/Botimi Në një revistë periodike kombëtare me karakter ekonomik 1 (një) ditë, në datën 23.09.2024 (ditë e hënë).

Përmbajtja: Botimi/publikimi i 1 (një), 2 faqe të një reviste kombëtare, me ngjyra, në gjuhën shqipe.

Fondi limit i përcaktuar: 80,000 lekë (tetëdhjetë mijë lekë).

Afati i fundit Për paraqitjen e konfirmimeve nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara është deri më dt. 20.09.2024, në orën 15.00, pranë Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, dhe në adresën email të personit përgjegjës juli.binjaku@kesh.al;

Konfirmimet:

Duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf, të shënuara me adresën dhe emërtimin e subjektit, në rast të kundërt ata do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Konfirmimet duhet të jenë në gjuhë Shqipe.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë autoritetit tonë kontraktor konfirmimet tuaja.

Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:

1. Dokument nga autoriteti përkatës, që vërteton se operatori ushtron këtë aktivitet ekonomik tregtar.
2. Dokument që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2023.

Përzgjedhja dhe vlerësimi i ofertave:

Përzgjedhja e ofertave sipas pikës nr. 7 dhe 12 të VKM nr. 1195 datë 05.08.2008

• Vlerësohet me 50 pikë faktori i impaktit:

Faktori i impaktit është masa në të cilën artikulli/njoftimi do të aksesohet nga personat që mund të shfaqin interes, për shkak të tirazhit dhe informacionit të përcjellë nga periodiku.

• Vlerësohet me 50 pikë oferta më e ulët ekonomike e operatorit.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në Lek.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të ofertave përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive pranë KESH sh.a. ose para komisionit në datën dhe orën e përcaktuar si dhe të dërgohen nga adresa zyrtare email-i i agjensisë së medias apo organit të shtypit, me nënshkrim elektornik nga përfaqësues i kompanisë dhe do të dërgohen në email-in e personit përgjegjës të kësaj procedure juli.binjaku@kesh.al.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.

KRYETAR I KOMISIONIT TË MEDIAS

Evi Robo

